



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 6.12.2018

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 9918, DATE 19.5.2008
“PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR” (nismë deputeti)

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 9918, date 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 6 dhjetor 2018.

Ky projektligj është nismë e deputetit Eduard Shalsi dhe paraqitet për shqyrtim në Kuvend bazuar në nenin 81 pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhje ishin të ftuar edhe përfaqësues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është t’i krijojë hapësirën e duhur ligjore AKEP-së për rregullimin e:

- tarifave të *roaming-ut* ndërkombëtar, tarifave me pakicë, të përdoruesve celularë të operatorëve shqiptar kur këta vizitojnë vendet e tjera;
- tarifave me shumicë që operatorët e vendeve të tjera paguajnë kur përdoruesit e tyre vizitojnë Shqipërinë; si dhe
- tarifave të shërbimeve të lidhura me *roaming-un* ndërkombëtar.

Ndryshimi i propozuar i hap rrugën rregullimit të *roaming-ut* nga AKEP-ja mes Shqipërisë dhe Kosovës (*Zero Roaming*), apo dhe me vende të tjera të rajonit mbi bazën e marrëveshjeve reciproke bilaterale, multilaterale dhe rajonale.

II. ARGUMENTIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTAKTIT

- *Roaming në BE*

Komisioni European vendosi për fillimin e aplikimit të *Roam Like At Home* (RLAH) duke filluar nga data 15 Qershor 2017. Nëpërmjet RLAH qytetarët në vendet anëtare të BE-së nuk kanë më tarifa/kosto shtesë me pakicë në faturat që kanë me operatorët vendas kur ata vizitojnë vende të tjera anëtare të BE-së. Që prej qershorit 2017 një european paguan për *roaming* të njëjtin çmim si në vendin rezident.

Rregullimi i *roaming-ut* ndërkombëtar në vendet e BE-së është kryer nëpërmjet rregullimit në nivel komunitar nga institucionet e BE-së dhe ka sjellë përfitime të mëdha për qytetarët e vendeve anëtare të BE-së në përdorimin e shërbimeve celulare.

Kur miratuan marrëveshjen për heqjen e tarifës së *roamingut* brenda BE-së, Parlamenti European dhe Këshilli, i kërkuan Komisionit European të ndërmernte disa masa mbështetëse për ta bërë këtë iniciativë funksionale, si:

- Rregulla për “përdorim të ndershëm” që mund të ndërmarrin operatorët për të parandaluar përdorimin abuziv apo anormal të sistemit, si rishitja sistematike e kartave SIM me çmim të ulët për përdorim permanent në vendet e tjera. Këto politika të ndershme janë të domosdoshme për të evituar efektet negative ndaj konsumatorëve në tregjet vendase;
- Përcaktimi i një skeduli me çmime *roaming*;
- Një sistem uljeje të veçantë e të përkohshëm për operatorët, për t’u përdorur në rrethana strikte kur tarifat fundore të *roaming-ut* në një treg specifik mund të çojnë në rritje të çmimeve të abonentëve të operatorit, dhe kjo vetëm nëse autorizohet nga rregullatori kombëtar.

Nga këndvështrimi i konsumatorit RLAH ka qenë një sukses i madh. Me njohjen dhe sensibilizimin e kësaj nisme që ka hyrë në fuqi në qershor 2017, është rritur edhe trafiku. Shumë konsumatorë europianë po shijojnë konektivitetin me kosto të ulët dhe cilësi të lartë në të gjithë BE-në. Politika e përdorimit të ndershëm e Komisionit European qartëson të drejtat e konsumatorit duke parashikuar mbrojtje për të siguruar që ofertat konkurruese vendase të mbeten atraktive.

Ndjesia pozitive e konsumatorit ka shtuar besnikërinë e konsumatorit ndaj kompanisë, duke i ofruar operatorëve mundësinë perfekte për të krijuar paketat e tyre sipas nevojave dhe për të kontraktuar shërbimet e tyre tek të tretë për një bazë receptive të orientuar drejt përdoruesit.

Ndërkohë, qëndrimi i operatorëve në fillim të vendosjes së RLAH ishte më pak pozitiv. Një humbje nga kombinimi i tarifave me valën e trafikut ishte në mënyrë të kuptueshme e vështirë për t’u pranuar nga operatorët. Ka pasur një pasiguri në fillim të zbatimit të tarifave të reja *roaming* në BE nga industria, por një vit më pas pranojnë gjerësisht se çdo lëvizje drejt rritjes së përdorimit të celularit është një gjë e mirë.

• **Roaming në Ballkan**

Për vendet joanëtare të BE-së, marrëveshjet bilaterale, multilaterale dhe rajonale konsiderohen një instrument shumë i mirë për të reduktuar apo eliminuar tarifën e *roaming-ut* ndërkombëtar edhe nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU).

Rregullimi i tarifave të roamingut në Ballkan lidhet me zbatimin e angazhimeve të marra në Samitin e Triestes në 12 korrik 2017 “Për krijimin e Zonës Ekonomike Rajonale WB6”. Gjithashtu, lidhet me Samitin e Sofjes, planin shumëvjeçar për zonën Ekonomike Rajonale, (MAP-REA) të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në shtyllen dixhitale, është parashikuar rregullimi i roamingut në WB6 Perëndimor sipas modelit të Bashkimit Europian.

Agjenda Digjitale për Ballkanin Perëndimor është një nga shtyllat kryesore të Strategjisë së Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor, botuar në shkurt të vitit 2018. Kjo agjendë u shpall në Samitin Digjital të mbajtur në Sofje në 17 qershor 2018 dhe përfshin 6 vende të Ballkanit Perëndimor si: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova dhe Serbia.

Agjenda ka katër shtylla kryesore ku një prej tyre ka të bëjë me investimet në lidhjet transmetuese (*broadband connectivity*). Një infrastrukturë e mirë digjitale është esenciale për hapjen e transmetimit në Ballkan. Në këtë kuadër po punohet për të zhvilluar një marrëveshje rajonale *roaming*, duke përfshirë gjashtë partnerët e rajonit, nga e cila do të përfitojnë të gjithë konsumatorët brenda rajonit, krahas përpjekjeve paralele për uljen e tarifave me BE-në.

Aktualisht, në Ballkanin Perëndimor, katër vende të këtij rajoni Mali i Zi, Serbia, Bosnje - Hercegovina dhe Maqedonia, në vitin 2014 kanë nënshkruar një Marrëveshje Rajonale për *Roaming-un* Ndërkombëtar, e cila përcakton se tarifat *roaming* midis këtyre vendeve, tarifat me shumicë midis operatorëve celularë dhe tarifat me pakicë për t’u aplikuar për pajtimtarët e shërbimeve celulare gjatë *roaming-ut* në këto vende do të rregullohen sipas çmimeve të aplikuara midis vendeve të BE-së.

Qeveria shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim dhe me AKEP-në, ka kryer procedurat për aderimin e Shqipërisë në këtë marrëveshje, duke i kërkuar këtyre vendeve përfshirjen e Shqipërisë në të.

- ***Roaming me Kosovën***

Sipas të dhënave të AKEP Kosova është vendi me të cilin Shqipëria shkëmben më shumë trafik në roaming ndërkombëtar në vendet e rajonit.

Në maj 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar një Rezolutë (Nr.06-R-004) për heqjen e Roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë ku autorizohet Qeveria e Republikës së Kosovës, që në kuadër të integritetit ekonomik me Shqipërinë, të nisë procedurat për arritjen e marrëveshjes për heqjen e tarifave të *roaming-ut* në telefoninë celulare ndërmjet qytetarëve të dy vendeve respektive. Gjithashtu, sipas kësaj rezolute, autorizohet Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Kosovës në bashkëpunim me atë të Shqipërisë të kujdeset për zbatimin e marrëveshjes së arritur.

Sapo është nënshkruar edhe marrëveshja mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Kosovës për të mundësuar heqjen graduale të *roaming-ut*.

Meqenëse hapi i parë për t’u angazhuar në lidhjen e këtyre marrëveshjeve është krijimi i hapësirës ligjore, propozohet kjo shtesë në ligjin nr. 9918, date 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në

Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Konkretisht, bëhet një shtesë në nenin 55 të ligjit, i cili i jep të drejtë AKEP-së të zbatojë dhe të vendosë rregullimin e shërbimeve të përfshira në skemën e shërbimit universal, të ofruara nga ofruesi i shërbimi universal; shërbimet e ofruara nga sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg; dhe me shtesën e propozuar shtohen edhe shërbimet e *roaming-ut* mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u shprehën se propozimi është në harmoni me të gjitha nismat që ka ndërmarrë Ministria gjatë këtij viti. Nisma është në përputhje edhe me angazhimet që janë marrë në Samitin e Triestes dhe në përputhje me deklaratën e Samitit të Sofjes për Agjendën Digjitale.

Përfaqësuesit e AKEP-së u shprehën dakord me propozimin duke propozuar edhe një shtesë që lidhet me tarifat e terminimit ndërkombëtar të lidhura me shërbimet e *roaming-ut*. Duke iu përgjigjur interesit të deputetëve në lidhje me një dëmtim të mundshëm të kompanive celulare nga *roaming-u* i reduktuar, ata sqaruan se aktualisht operatorët, veçanërisht në periudhën e verës aplikojnë tarifa me shumicë *roaming-u* shumë të reduktuara dhe sipas llogaritjeve humbja që do të kenë të gjitha kompanitë celulare nga zbatimi i marrëveshjeve do të jetë një shifër shumë e ulët.

Në kuadër të negociatave të nisura për një marrëveshje të re rajonale për *roaming-un*, ministria dhe AKEP kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm me kompanitë celulare për t’i njohur ato me procesin dhe hapat e mëtejshme që do ndërmerren.

III. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektligji nuk përafron asnjë akt komunitar dhe nuk lidhet me detyrimin për zbatimin e ndonjë *acquis* specifik të BE-së.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni duke e cilësuar si një hap shumë pozitiv ndikimin që do të kenë këto marrëveshje për konsumatorin shqiptar, me shumicë votash u shpreh dakord në parim dhe për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit nën për nën Komisioni pasi u njoh me mendimin e përfaqësuesve të AKEP-së dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me nismë, pranoi sugjerimin e AKEP duke vendosur riformulimin e shkronjës “c” në nenin 1 si më poshtë:

“c) shërbimet e *roaming-ut* mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumë palëshe të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime.”

Rakip SULI

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar